



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:042871
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05475230

C.nr.295/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NTSH “Sh...”, me seli në Gjakovë, Rr. “...”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Prenk Pepaj, avokat në Gjakovë, kundër të paditurit U.D., nga fshati .. komuna e Gjakovës, duke vendosur sipas padisë për pasurimin e pa bazë, vlera e objektit të kontestit 1,944.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e evidentuar me numër C.nr. 295/20, e datës 30.03.2020 e paditësit NTSH ‘...’, me seli në Gjakovë, Rr. “.. kundër të paditurit U.D., nga fshati ... komuna e Gjakovës, me bazë juridike pasurim i pa bazë, vlera e objektit të kontestit 1,944.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 30.03.2020 ka parashtruar padi kundër të paditurit U.D nga fshati ..., komuna e Gjakovës, me bazë juridike pasurim i pa bazë, vlera e objektit të kontestit 1,944.00 euro

Gjykata ka mbajtur seancën përgatitore me datë 20.10.2023, në të cilën seancë nuk ka prezantuar i padituri, pasi që nga fletëkthesa në shkresa të lëndës është konstatuar se “*pala i panjohur në këtë adresë, në këtë adresë jeton familja e V.K.*”. Atëherë gjykata në këtë seancë përmes Aktvendimit ka obliguar paditësin që në afat prej tre ditësh të gjej adresën e saktë të të paditurit nën paralajmërim të pasojave ligjore, mirëpo paditësi nuk ka plotësuar padinë siç është obliguar nga gjykata.

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 3 të LPK-së, ku është paraparë se “*Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë*”, dhe duke marrë parasysh faktin se as pas vendimit të dërguar nga gjykata nuk është plotësuar padia brenda afatit të përcaktuar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.295/20, datë 20.03.2024

Gjyqtarja
Fëllanza Knushaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.